V E N D I M
Nr. 637, datë 30.11.2000

PËR MBYLLJEN E DISA MINIERAVE TË HEKURNIKELIT NË RRETHET POGRADEC DHE LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998, "Për strategjinë e priviatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", ndryshuar me ligjin nr.8582, datë 23.2.2000, dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të mos vlerësohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë dhe të kalojnë në mbyllje ndërmarrjet minerare dhe minierat e hekurnikelit:

- Ndërmarrja minerare e hekurnikelit, Guri i Kuq rrethi Pogradec
- Miniera e hekurnikelit, Prrenjas rrethi Librazhd
- Miniera e nikelsilikatit, Katjel rrethi Librazhd
- Sektori minierar Bushtricë (traverbanku H-385) rrethi Librazhd

2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, brenda muajit shkurt 2001, të përfundojë projektet, ndërsa mbyllja e tyre të përfundojë brenda vitit 2001.

3. Shpenzimet për mbylljen e minierave të përballohen nga fondi buxhetor, në zërin "Konservim dhe mbyllje miniere", i cili do të programohet në vitin 2001, për Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Makineritë, pajisjet, materialet dhe objektet sipërfaqësore të privatizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, ose të dërgohen në minierat e tjera, të cilat e vazhdojnë veprimtarinë.

5. Punonjësit, të cilët deri më datën 1.1.2000 kanë qenë në marrëdhënie pune dhe që do të jenë të tillë deri në çastin e mbylljes së minierave, të trajtohen duke nisur nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për 1 (një) vit me pagën minimale në shkallë vendi. Kjo pagesë ndërpritet për punonjësit të cilët kryejnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit ose të vetëpunësimit, brenda periudhës së trajtimit në këtë pagesë.

6. Periudha 1 (një) vjeçare t'u njihet punonjësve, që do të dalin të tepërt dhe do të trajtohen sipas këtij vendimi, si vjetërsi pune për efekt pensioni dhe të shënohet si e tillë në librezën e punës.

7. Fondi prej 22 milionë lekësh për trajtimin e punonjësve që humbasin vendin e punës të përballohet nga fondi buxhetor që do të miratohet për vitin 2001 për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta